



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**- Këshilli Drejtues -**

---

**V E N D I M**  
**Nr. 1128 , datë 26.01.2010**

**Për**  
**“Miratimin e dokumentit për këshillim publik: “Mbi pagesat që kryhen në AKEP””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e dates 26.01.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, mori në shqyrtim dokumentin e përgatitur nga Grupi i Punës për këshillim publik: “Mbi pagesat që kryhen në AKEP”.

**I. BAZA LIGJORE:**

1. Neni 110, neni 78 dhe 86 si dhe neni 119, shkronja (c) dhe (ç), te ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Pikat 12 dhe 17 të nenit 21 dhe neni 23, pika 3, shkronja (f) e “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

Nga shqyrtimi i materialit dhe diskutimeve të anëtarëve të Këshillit Drejtues, si dhe baza ligjore e mësipërcituar,

**II. VËREHET se:**

1. Sipas pikës 2 të nenit 119 të ligjit nr. 9918 citohet se: “ *Përcaktimi i pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave dhe numrave, të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e AKEP-it*”.

2. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, me Urdhër Nr.519, datë 23.12.2009, është ngritur Grupi i Punës për përgatitjen e dokumentit “Mbi pagesat që kryhen në AKEP”, bazuar në nenin 119, germa (c) dhe (ç).

3. Ky dokument, së bashku me dokumentin për pagesën për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike (në baze të nenit 119 germa (a), përbëjnë paketën e akteve nënligjore mbi pagesat që kryhen në AKEP, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së tij si organ rregullator në zbatimin të ligjit nr. 9918.

4. Dokumenti për këshillim publik, përmban pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, numrave dhe serive numerike, dhe është hartuar duke marrë si reference kryesore këto faktorë:

- a) Eksperiencën dhe çështje të hasuara gjatë implementimit të VKM nr. 75, datë 06.02.2003;
- b) Modelet e disa vendeve të rajonit; dhe
- c) Syzjerimet e Konsulentit DDL, në kuadrin e Projektit të BERZH/EU për Shqipërinë.

### **III. PËRFUNDIMISHT**

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, si për AKEP-n ashtu dhe për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike,

### **IV. VENDOSI:**

1. Të miratojë për këshillim publik dokumentin bashkëlidhur (Shtojca 1), “Mbi pagesat që kryhen në AKEP”.
2. Periudha e këshillimit publik do të jetë 30 ditë nga data e publikimit të dokumentit në Internet në faqen e AKEP.
3. Ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me Urdhër Nr.519, datë 23.12.2009, për administrimin e procesit të këshillimit publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**A N Ë T A R Ë:**

**1. Alketa MUKAVELATI**

**2. Benon PALOKA**

**3. Ibsen ELEZI**

**4. Zamira NURÇE**

# **P E R M B A J T J A**

Parathënie	2
1 HYRJE	3
2. PAGESAT AKTUALE TE SPEKTRIT	4
3 PËRDORIMI OPTIMAL I RADIO SPEKTRI	4
4. PROPOZIMET E PAGESAVE PER SPEKTRIN E FREKUENACAVE RADIO	6
4.1. Sherbimi telefonik publik i levizshem tokesor	6
4.2 Sherbimi privat i levizshem radio – PMR	7
4.3 Sherbimi i levizshem TETRA ( Terrestrial Trunked Radio )	8
4.4 Sherbimi kerkimit te personit ( Paging )	8
4.5 Lidhjet fikse radio	12
4.6 Sherbimi radio FWA/BWA	16
4.7 Sherbimet Satelitore	18
4.8 Licensat radio te anijeve	23
4.9 Licensat radio te avionave	24
4.10 Autorizimet individuale per qellime kerkimi, matjeje dhe prove	24
4.11 Autorizime individual per ngjarje te vecanta.	25
4.12 Shërbimi RadioAmatori	26
4.13 Pagesa te tjera	27
5. PAGESAT PER CAKTIMIN DHE PERDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE	27
6. KRAHASIMI I PAGESAVE TE PROPOZUARA ME VENDET E TJERA.	
6.1 Hyrje	30
6. 2 Lidhje fikse radio	30
6.3 Sherbimi privat i levizshem radio – PMR.	30
6.4 Licensat radio detare dhe avion	30
7. PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJE PËR KONSULTIM	32

## **Parathënie**

AKEP, ne baze te Ligjit Nr 9918, date 19.5.2008 “Per Komunikimet Klektronike dhe Postare” (Ligji), Nenit 3, Pika a) eshtë autoriteti rregullator kombëtar, përgjegjës për të administruar spekttrin e frekuencave te caktuara per qellime civile, pervec frekuencave te caktuara per transmetimet radio dhe televizive. Ne baze te Nenit 65, Pika 1), perdorimi i frekuencave eshte i mundur, nga personat fizikë apo juridikë, vetëm pasi jane pajisur me autorizim nga AKEP. Të drejtat individuale te përdorimit për frekuencave të radios, janë dhene për lloje të ndryshme të shërbimeve radio, me Autorizim Individual per Perdorimin e Frekuencave, sic percakton Neni 66, Pika 1 e Ligjit.

Neni 119, Pika c) dhe ç) i Ligjit percaktojne se sipermarresit, perdorues te frekuencave radio duhet te kryejne pagesat ne AKEP,

a) Për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas përcaktimeve në nenin 78 të Ligjit; dhe

b) Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike, sipas përcaktimeve në nenin 86 të Ligjit.

Pagesat qe kryen ne AKEP per perdorim e frekuencave, per sherbimet e ndryshme radio, kane per qellim sigurimin e perdorimit optimal te frekuencave te dhena ne perdorim. Pagesat per frekuencat ne perdorim jane caktuar kohe me pare, me vendimin e Keshillit te Ministrave Nr 75, date 06.02.2003 (i ndryshuar). Koha e gjate qe ky VKM eshte ne fuqi nuk i pergjigjet kerkeses, qe pagesat per caktimin dhe perdorimin e frekuencave, te synojne perdorimin optimal te frekuencave radio.

Me kalimin e viteve, kërkesa në rritje për radio frekuencave, vecanerisht ne breza te caktuar te frekuencave dhe në zona të veçantë, ka çuar në denduri te madhe te perdorimit te frekuencave.

Ky konsultim publik synon marrjen e komenteve per nivelin dhe strukturen e ketyre pagesave, per gjithë gamen e gjere te shërbimeve radio, me qellim berjen e tyre transparente dhe zvogelimin e veprimeve administrative, dhe me qellim përdorimin optimal të spektrit.

Pagesat e rishikuara dhe strukturat e llogaritjes se tyre janë propozuar për të gjithë lidhjet fikse radio, sistemet radio per sherbimin privat te levizshem tokesor, sistemet Tetra e te kerkimit te personit (paging), radio anijeve, radio avionave, radio amaret dhe per prove dhe eksperimentim.

Shpresojme se keto propozime do të inkurajojë përdorimin më të gjerë dhe më efikas të spektrit radio dhe do të sjellin përfitime për të autorizuarit, operatorë te komunikimeve elektronike dhe konsumatorët.

Mirëpresim pikëpamjet tuaja mbi secilin nga këto propozime.

## **I. HYRJE**

Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP ne baze te Ligjit 9918 është përgjegjës për dhënien e të drejtave te përdorimit te frekuencave radio, në Shqipëri. Këto të drejta jepen me Autorizim Individual per Perdorimin e Frekuencave, miratuar me Vendimin e Keshillit Drejtues Nr 510, date 4.11.2009.

Sipas Ligjit dhe legjislacionit te BE, AKEP duhet të caktojë pagesa, të cilat duhet të sigurojnë përdorimin optimal të spektrit të radios. Keto pagesa duhet të jenë objektivist të justifikuara, jo-diskriminuese, proporcionale, te nxisin konkurrencen, përdorimin efikas dhe sigurimin e menaxhimit efektiv të frekuencave radio.

Pagesat qe aplikohet aktualisht ne AKEP, nga sipërmarresit, për të drejtën e përdorimit te frekuencave radio jane vendosur para miratimit te Ligjit, (VKD Nr 75, date 6.2.2003) dhe në disa raste mund të mos jenë plotësisht në përputhje me nevojën për të siguruar përdorimin optimal të spektrit.

Qëllimi i këtij dokumenti është të rishikojë pagesat e tanishme, te aplikuar për shërbime të caktuara radio dhe të kërkojë mendimet komente mbi ndryshimet e propozuara, për të sjellë strukturat e pagesave, sa me shume te jete e mundur, në përputhje me objektivat AKEP per përdorimit efikas dhe menaxhim efektiv të spektrit të frekuencave radio.

Ky konsultim bën propozime, që lidhen me pagesat dhe strukturat e saj, për frekuencat qe perdoren, shërbimin privat te levizshem radio – PMR , shërbimet paging, detar, aeronautik, radioamator, prove dhe eksperimentim si dhe propozon shqyrtimin e pagesave te lidhjeve fikse radio, lidhjeve fikse satelitore dhe brezave te caktuar per shërbimin e levizshem telefonike GSM/UMTS.

Këto propozime janë parashikuar të inkurajojnë shfrytëzimin efikas te spektrit nga sipërmarresit, operatorë te rrjetit te komunikimeve elektronik publike e private dhe përdoruesit e pajisjeve-radio.

Është parashikuar që propozimet të kenë një ndikim të dobishëm si në këto sektorë dhe tek konsumatorët dhe, në kontekst më të gjerë, të përfitojë ekonomia publike.

### Dergimi i Komenteve

Të gjitha komentet janë të mirëpritura. Do te vleresonim qe cdo koment/pergjigje t'i referohet pyetjes me numrin perkates qe ka ky dokument konsultimi. Kjo menyre e paraqitjes se komenteve do te ndikojne ne shkurtrimin e kohes se analizes se tyre dhe aplikimin ne praktik me qellim lehtesimin e analizes se tyre.

Periudha e konsultimit do të zhvillohet nga 26.01.2010 deri me 24.02.2010.

Gjate kesaj periudhe AKEP mirëpret komentet me shkrim për çdo çështje te ngritur në këtë dokument.

AKEP, me qëllim transparencën dhe nxitjen e interesimit, per kete dokument konsulence, do te publikojë komentet e gjithë te interesuarve për këtë konsultim.

AKEP vlerëson, se shumë nga çështjet e ngritura në këtë dokument mund të kërkojë nga te intervistuarit të japin informacion konfidencial, qe komentet e tyre të jenë te kuptueshem dhe te mire argumentuara. Informacioni i cilesuar i tille do te trajtohet ne perputhje me dispozitat ligjore, per ruajtjen e mos publikimin e informacionit konfidencial, per te ruajtur fshehtësine e tij.

## **2. PAGESAT AKTUALE TE PERDORIMIT TE FREKUENCAVE.**

Pagesat aktuale, per perdorimin e frekuencave behen sipas VKM Nr.75, date 06.02.2003. Keto pagesa janë bazuar përgjithësisht ne pagesat "për licencë" ose për pajisjet ne vartesi te kategorise se licenses, me te cilen sipermarresit kane qene pajisur.

Permbajtja e plote VKM Nr.75, date 6.2.2003 mund te gjendet ne faqen elektronike te AKEP me [www.akep.gov.al](http://www.akep.gov.al).

Ne materialin ne vijim te ketij dokumente jepen per reference pagesat aktuale per perdorimin e frekuencave per sherbimet e ndryshme radio.

## **3. PERDORIMI OPTIMAL I SPEKTRIT RADIO**

Roli i AKEP si administrator i spektrit, ka detyren të siguroje përdorimin optimal të burimeve të spektrit. Sipas Ligjit dhe legjislacionit te BE, sipermarresit duhet te kryejne pagesa per caktimin dhe përdorimin e frekuences/ave. Keto pagesa duhet te ndikojne ne përdorim optimal të spektrit. Përdorimi optimal varet nga shumë faktore, por AKEP , me te rëndësishem, vlereson keta:

### **1. Ekonomik:**

Spektri i përdorur ne shërbimet me një perdorim të lartë dhe kane nje rendesi te vecante per zhvillimin e tregut te komunikimeve elektronik, pritet qe vlere e tij, per perdorim te rritet.

### **2. Social - Ekonomik:**

Spektri përdoret për shërbime ne përfitim te shoqërise, Spektri i tille radio qe perdoret per shërbime emergjente dhe ndihmë ne sigurine jetike, prandaj pagesat që behen per kete spekter nuk pasqyrojne plotësisht vleren vetiake te tij.

### **3. Shoqëror:**

Përdorimi i spektrit qe të mund të përfitoj shoqëria, për shembull, disponueshmëria e spektrit për qëllime të eksperimentimit dhe prove, e për aplikacione të cilat nuk kanë hyre ne tregun komercial, mund të stimulojë risi. Ky "Përfitim shoqëror" duhet të konsiderohet kur vendoset përdorim optimal i spektrit dhe i nivelit përkatës te pageses per perdorimin e tij.

### **4. Politik:**

Pagesat e spektrit mund të përdoret për të ndikuar në përdorimin e spektrit në një mënyrë që të përmbushë objektivat e politikave publike, p.sh. inkurajimin e përdorimit të spektrit në grupe të caktuara dhe dekurajon atë në të tjerët, me qëllim inkurajimin e përdorimit të rrjeteve broadband ose zhvillimin e infrastrukturës alternative.

#### 5. Menaxhimi i spektrit:

Përveç faktorit politik, përdorimi i spektrit dhe menaxhimi i mirë i tij me efikasitet, jep mundësi futjen në treg të lojtareve të rinj në tregun e komunikimeve elektronike. Bashkëpunimi me autoritetet homologe të vendeve fqinje dhe marrëveshjet e perbashketa me to, për koordinimin ndërkufitar, për pjesë të ndryshme të spektrit.

#### 6. Teknologjik:

Faktorët të tilla si venia në përdorim e pajisjeve të reja radio me karakteristika me cilësore lidhur me efikasitetin e spektrit do të ndikojë në përdorim të spektrit dhe ndryshimin e pagesave duke i çuar ato drejtë realitetit.

#### 7. Pajtueshmërinë me detyrimet ndërkombëtare:

Bazuar në Ligjin dhe VKM Nr. 479, datë 6.5.2009 “Për Miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”, përdorimi dhe administrimi i spektrit duhet të bëhet në baze të caktimit të pranuar ndërkombëtarisht për përdorimin e tij për shërbime të caktuara, p.sh. detare ose aeronautike dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

#### 8. Kosto e mundshme e spektrit:

Disa pjesë të spektrit në thelb janë më të vlefshme se të tjerët, por, për arsye historike, nuk mund të përdoren nga shërbime të tjera ndonëse mund të sjellin përfitim ekonomik. Si rrjedhojë mos përdorimi i kësaj pjesë spektri për shërbime të tjera radio, me përfitime ekonomike me të mira, mund të justifikojë një pagesë përdorimi me të lartë, se sa kostua reale.

*Pyetja 1. A ka faktorë të tjerë, të pa përmendur më sipër, që AKEP duhet të marrë në konsideratë për përdorimin optimal të spektrit të radios dhe vendosjen e pagesave për përdorimin e spektrit të frekuencave?*

## **4. PROPOZIMET E PAGESAVE PËR SPETRIN E FREKUENCAVE PËR SHËRBIMET RADIO**

## **SHERBIMET RADIO TE LEVIZSHEM TOKESOR**

Ne kete sherbim radio perfshihet sherbimi telefonik publik i levizshem tokesor : GSM, UMTS, PAMR (sherbimet trunk radio, TETRA), sherbim radio kerkim personi (Paging) dhe sherbimet private te levizshme radio PMR.

### **4.1. Sherbimi telefonik publik i levizshem tokesor.**

Pagesat vjetore aktuale per perdorimin e frekuencave per sherbimin telefonik publik te levizshem tokesor ( GSM 900/1800), jane:

- 100.000 leke / ne vit per cdo kanal 2x200 kHz,

Ne keto pagesa nuk eshte marr parasysh brezi i frekuencave.

AKEP, duke vleresuar avantazhin qe kane frekuencat radio te brezit 900 MHz ndaj atij 1800 MHz,

#### **Propozon:**

1. Pagesat vjetore do te jene :

a) Per brezin GSM900, cdo kanal 2x200 kHz : 120.000 leke

b) Per brezin GSM1800 cdo kanal 2x200 kHz : 100.000 leke

c) Per brezat UMTS:

i. Ne brezin (1920-1980) dhe (2110-2170) MHz,

per cdo brez frekuece me gjeresi (2x5) MHz: 2.000.000 leke

ii. Ne brezin (1900-1920) MHz dhe (2020-2025) MHz, per cdo gjeresi brezi

(1x5) MHz, perdorim jo i ciftuar me brez tjeter: 1.000.000 leke

2. Ne rast se operatori do te perdor breza te frekuencave ne brezat GSM 900/1800 MHz dhe ata te sherbimit UMTS/IMT2000, atehere pagesa do te llogaritet si shume e pagesave te cdo brezi.

3. Kur autorizimi individual jepet per njeh pjeseh te njeh vitit, pagesa per perdorimin e frekuencave llogaritet si vijon:

$$C = A \times (B/12)$$



Ku :

A - pagesa perkatese vjetore, sipas gjerese se brezit te dhene ne përdorim,

B - numri i muajve te vitit, gjate te cileve autorizimi eshte i vlefshem. Kur autorizimi eshte dhene per nje periudhe me te vogel se nje muaj, per qellim llogaritje, ai do te konsiderohet si nje autorizim qe leshohet per nje periudhe nje mujore.

C- pagesa e llogaritur për tu paguar.

## Pyetje

*Pyetja 2. Cilat janë pikëpamjet tuaja për pagesat vjetore që propozohen për brezat GSM900/1800 dhe UMTS?*

### 4.2 Sherbimi privat i levizshem radio – PMR

Ne kushtet e zhvillimit te ekonomise se tregut, sidomos ne zonat me dendesi te madhe te popullise dhe zhvillim te larte ekonomik, lind nevoja e komunikimeve telefonike, per t'i ardhur ne ndihme ketij stadi te zhvillimit ekonomiko-shoqeror.

Krahas llojeve te tjere te sherbimeve te telekomunikacionit, fiks dhe te levizshem (GSM900/1800), per te ndihmuar ne mbarevajtjen e punes, ne pergjithsi, dhe ndjekjen e vazhdueshem te aktivitetit ekonomik, qe zhvillojne shoqeri e kompani te ndryshme, nje vend te rendesishem, zene dhe sistemet e radiokomunikacionit private te quajtura PMR (Private/Professional Mobile Radio). Ky sherbim radiokomunikacioni i levizshem tokesor eshte shume i ndryshem nga sherbimi publik telefonik i levizshem (GSM 900/1800), dhe me kosto me te vogel.

Sistemet private te radiokomunikacionit, perdoren kryesisht per sherbime emergjente dhe sigurie duke transmetuar mesazhe zonor dhe data midis:

- nje stacioni baze dhe stacioneve portative dore ose te montuar ne makine, apo
- midis stacioneve portative dore ose te montuar ne makine,

per te ndihmuar aktivitetin e biznesit.

Brezat civil – CB ( p.sh. PR27) nuk jane pjese e sistemeve PMR

Gjithashtu stacionet e radionderlidhjes bregdetare dhe stacionet aeronautike ne toke perdorin po keto sisteme komunikimi radio.

Pagesa aktuale vjetore qe aplikohen për sherbimet e pavarur te radiokomunikimit te levizshem PMR dhe Radio alarm jane:

**Radiokomunikim** : 5.000 leke per sistem radio PMR simpleks; dhe  
15.000 leke per sistem radio PMR dupeks/1/2dupeks.

**Radio Alarm** : 15.000 leke per sistem.

Pagesat vjetore për **Stacionet bregdetare** dhe Stacionet tokesore te radiokomunikimit për **Sherbimin aeronautik** jane, perkatesisht:

20.000 leke/vit dhe 15.000 leke/vit.

Pagesat e mesiperme aplikohen për të gjitha sistemet radio PMR, pavarësisht zones së mbulimit.

Pra, pagesa për një sistem PMR, radiokomunikim, dupkes, me zone mbulimi deri 15 km, ka qene e njejte me ate te nje sistemi PMR, qe perseritesin e vendosin ne vend te larte, mbi nivelin e detit, dhe sigurojnë një shërbim në një zonë deri 50 km apo me teper.

#### **4.3 Sherbimi i levizshem TETRA ( Terrestrial Trunked Radio )**

Aktualisht ka një strukturë të veçantë pagese për sistemet Trunk Radio dhe Tetra ( qe faktisht eshte i njeti sherbim). Keto shërbime radio, përdorin disa kanale frekuencash, për të mundësuar kapacitetin e larte te trafikut te bisedave radio.

Pagesa vjetore qe aplikohen për shërbimet Trunk Radio dhe TETRA jane:

##### **Trunk Radio**

10.000 leke për sistem Rajonal; dhe  
25.000 leke për sistem Kombetar.

##### **TETRA**

30.000 leke për sistem Rajonal; dhe  
75.000 leke për sistem Kombetar

#### **4.4 Sherbimi kerkimit te personit ( Paging )**

Struktura e pageses për sistemet Paging eshte e vecante. Ky sherbim radio, i cili perdor nje frekuence radio dhe realizon transmetimin e te dhenave, me qellim emergjence, vetem ne nje drejtim eshte me i mbrojtur nga nderhyrjet.

Pagesa vjetore qe aplikohen për shërbimet Paging jane:

30.000 leke për sistem Lokal; dhe  
75.000 leke për sistem Rajonal

AKEP, me kete dokument konsultimi synon të rishikojë pagesat dhe strukturen e ketyre pagesave, për të gjitha sistemet radio PMR, Tetra dhe Paging, me synim aplikimin e një pagese baze, të njete për shërbimet e radios PMR.

#### **Propozimet**

AKEP propozon një strukturë, e cila përmban bazen për llogaritje të pageses, për të gjitha sistemet e radio komunikimit PMR, Tetra dhe Paging. Kjo ben qe, pagesa për cdo sistem radio të marr në konsiderate, parametrat e sistemit dhe të sigurojë përdorimin efikas të spektrit.

Qëllimi i kesaj strukture është të sigurojë qe:

a) Pagesa për cdo sistem radio PMR, TETRA dhe Paging, të reflektojë gjerësinë e spektrit qe i caktohet sipërmarresit për përdorim, dmth merr parasysh numrin e kanaleve të frekuencave, zonen gjeografike mbi të cilën sistemi radio operon, sasine e trafikut të gjeneruar

ne kete sistem radio si dhe mundesine e perdorimit te perbashket te spektrit te caktuar ketij perdoruesi me perdorues te tjere, ne te njejten zone gjeografike.

b) Kur sasia, gjeresia e spektrit te frekuencave te caktuar per perdorim eshte i vogel (p.sh. sistemet lokal (on-site), te cilet kane zone mbulimi te vogel dhe numer radiostacionesh portative (dore) te paket dhe, qe te njejtin spekter mund ta perdorin dhe sipermarres te tjere, pagesa do te jete e vogel, sepse kemi nje perdorim me efektivitet te spektrit ( I njeti kanal frekuenash perdoret bashkerisht-*share* nga disa sipermarres).

Për të realizuar objektivat e mësipërme, AKEP propozon:

a. Caktimin e **5 (pese)** kategorive te shërbimit radio PMR (radio komunikim dhe/ose radioalarm, transmetim te dhenash) duke percaktuar pagesa per frekuenca, ne vartesi te zones se mbulimit dhe gjerese se spektrit te frekuencave radio, qe jepet per perdorim.

b. Sistemet radio **TETRA ( Terrestrial Trunked Radio )** do të trajtohen si PMR ne njerën nga kategorite e sistemeve PMR ne vartesi te zones se mbulimit me sherbim.

c. Sistemet **Paging** do të trajtohen si PMR ne njerën nga kategorite e sistemeve PMR ne vartesi te zones se mbulimit me sherbim.

d. Afat maksimal i vlefshmerise se Autorizimit Individual per sistemet PMR, per te gjitha kategorite mendohet te jete 3 (tri) vjete me te drejte rinovimi.

e. Pagesa per perdorimin e frekuencave, mendohet te behet njeheresh per te 3(tri) vitet e vlefshmerise, para terheqjes te AI nga sipermarresi. Kjo do te eliminoje vonesat dhe kostot administrative te AKEP, qe nevojitet per te kryer rinovimin vjetor te ketyre autorizimeve

f. Sipermarresi i pajisur me Autorizim individual per sistemet PMR, brenda periudhes se vlefshmerise se tij, per ndryshime ne sistemin PMR, duhet te paraqese kerkese ne AKEP

Kur keto ndryshime ne sistemin PMR, rezultojne me rritje te vleres se pageses, atehere sipermarresi, do te paguaje diferencen duke aplikuar llogaritjen proporcionale me kohen (pro-rate). Ne rastin kur llogaritja e pageses eshte me vogel se ajo e paguara, AKEP nuk riburson sipermarresin per diferencen sic percaktohet ne nenin 76 pika e) dhe nenin 77 pika 3, te Ligjit 9918.

g. Ndryshimet e kerkuara ne sistemet PMR, brenda periudhes se vlefshmerise se Autorizimit, mendohet te jene jo me shume se 1 (nje) ndryshim ne nje vit kalendarik.

h. Kerkesa per rinovim e Autorizimit Individual do te paraqitet ne AKEP, 2 (dy) muaj para skadimit te vlefshmerise se tij.

i) Pagesa per caktim e frekuencave per cdo aplikim te ri, modifikim dhe rinovim te Autorizimit Individual per perdorimin e frekuences eshte 1.000 leke, Kjo shume do te paguhet bashke me pagesen per perdorimin e frekuencave para terheqjes se AI.

Pagesat e propozuara për kategoritë e ndryshme të sistemeve të shërbimit të levizshëm Radio – PMR dhe përkufizimet lidhur me termat e përdorura janë paraqitur më poshtë.

**Tabela Nr1**

Kategoria	Pershkrimi	Zona e ofrimit të shërbimit		Pagesa për cdo vit, për cdo sistem	
1	On-site Sistem	Zone gjeografike me reze deri në 3 Km		10.000 leke/kanal	
2	Stacion radiobregdetar/ stacion tokësor aeronatik,	Në qytetet bregdetare dhe aeroportet		10.000 leke/kanal	
3	Sistem PMR në zone lokale	Me rreze zone shërbimi		Pagesat sipas zonës 15 km dhe 30 km (përkatesisht)	
3.a	Me përdorim të vogël, deri në 15 nr përgj.pajisjeve radio të sistemit PMR	15 km	30 km	15.000	25.000
3.b	Me përdorim të mesëm, deri në 30 nr përgj.pajisjeve radio të sistemit PMR			25.000	35.000
3.c	Me përdorim të lartë mbi 30 nr përgj.pajisjeve radio të sistemit PMR			30.000	40.000
4	Sistem PMR në zone të gjera shërbimi				
4.a	Me përdorim të vogël, deri në 15 nr përgj.pajisjeve radio të sistemit PMR	Zone gjeografike me reze deri në 50 km		50.000	
4.b	Me përdorim të mesëm, deri në 30 nr përgj.pajisjeve radio të sistemit PMR			60.000	
4.c	Me përdorim të lartë mbi 30 nr përgj.pajisjeve radio të sistemit PMR			70.000	
5	Kanal radio për përdorim kombëtar	Kombëtar		100.000	

**Përkufizimet:**

**Kanali i frekuencave radio për sistemet PMR** - ka gjerësinë  $B = 12.5$  kHz. Pagesat e mesipërme i përkasin sistemeve dupleks të radio komunikimit. Në rastin e sistemeve simpleks sistemet PMR, pagesa do të llogaritet me gjysmën e vlerës/vlerave të tabelës së mesipërme.

**Kanal frekuence për përdorim të përbashkët** - do të kuptojmë atë kanal frekuence që është caktuar për tu përdorur, nga më shumë se një përdorues, në të njëjtën zonë mbulimi. Mundësia për përdorim të përbashkët, të një kanalit radio, varet nga trafiku radio dhe numri i përdoruesve të atij kanalit radio.

Përdoruesit radio PMR, të rastësishëm dhe të paket në numër, mund të përdorin të njëjtin kanal radio frekuence për sistemin PMR, me një sistem tjetër që është pothuajse në të njëjtet kushte (biseda të rastësishme dhe përdorues të paket).

**Përdorimi i Ulët** i referohet një sistemi PMR me numër përdoruesish, me radio portative, relativisht pak (zakonisht më pak se 15), i cili përdor një kanal në bazë të rastit. Në këtë sistem çdo përdorues pret të ndajë kanalin me deri në 5 përdorues të tjerë.

**Përdorim i Mesëm** i referohet përdorimit të një përdoruesi me më pak se 30 apo që përdorin radio kanal në një bazë të shpeshta. Një përdorues mund të presin gjithësisht ndarjen e kanalit deri në 3 përdorues të tjerë.

**Përdorimi i Lartë** i referohet një përdorues me një numër të madh të radio portative (30 ose më shumë) ose që përdor kanalin shumë shpesh. Zakonisht ky kanal jepet për përdorim jo të përbashkët-*share* me përdorues të tjerë.

**Stacionet bregdetare:** janë radiostacione të instaluar në tokë që përdorin kanale radio të brezit të frekuencave të përcaktuara për radiondërlidhjen detare dhe përdoren për të komunikuar me anije (midis stacionit radiobregdetar dhe anijeve).

**Stacionet tokësore Aeronautike:** janë stacionet e instaluar në tokë, që përdorin kanale radio të brezit aeronautik të frekuencave dhe përdoren për të komunikuar me avionat (komunikim Tokë – Ajër).

**Sistemet PMR On-Site** - Janë sisteme radiokomunikimi, që operojnë në një zonë të kufizuar gjeografike, me rreze deri në 3 km. Kanale të frekuencave radio të këtyre sisteme mund të përdoren dhe nga përdorues të tjerë.

**Sistemet PMR në Zone Lokale** - Janë sisteme radiokomunikimi që kanë për qëllim të mbulojnë me shërbim zonë gjeografike, me rreze deri në 15 km dhe deri 30 km, nga vendi i Stacionit Bazë (Përsëritesi), i vendosur në një vend të specifikuar gjeografikisht.

**Sisteme PMR me zone të gjere mbulimi** - Janë sisteme radiokomunikimi që kanë për qëllim të mbulojnë me shërbim zonë gjeografike, me rreze mbi 30 km deri në 50 km, nga Përsëritesi, i vendosur në një vend të specifikuar gjeografikisht, në lartësi të konsiderueshme, mbi nivelin e detit, për të zgjeruar zonën e mbulimit.

**Sisteme PMR me zone mbulimi kombëtar:** - Këto sisteme PMR janë të paket, por disa institucione shtetërore (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, etj) dhe shoqëri që ofrojnë shërbime publike ( KESH, Banka, etj), përdorin sisteme PMR, me zone mbulimi pothuajse kombëtar.

Këto sisteme me Përsëritesin Kryesor në Malin e Dajtit, sigurojnë lidhjen me përsëritsat lokalë në rrethet Shkoder, Pukë, Vlorë, Korçë e Gjirokastër, me një radio frekuence të vetme, që konsiderohet përdorim kombëtar i kësaj radiofrekuence.

## **PYETJE**

*Pyetja 3. Cili eshte mendimi juaj për pajisjen me AI me afat vlefshmerie maksimale 3(tri) vjecare dhe kryerjen e pagesave per perdorimin e frekuencave para marrjes se tij njeheresh per 3 vitet?*

*Pyetja 4. Cili eshte mendimi juaj për strukturën e propozuar te pagesave per sherbimet radio PMR, Tetra dhe Paging?*

*Pyetja 5. Cili eshte mendimi juaj për propozimet ndarjen ne kategori të ulët, të mesëm dhe të lartë te sistemeve PMR?*

*Pyetja 6. Cili eshte mendimi juaj lidhur me periudhën e zbatimit te kesaj strukture pagese?*

### **4.5. Lidhjet fikse radio**

Lidhje fikse radio percaktohet lidhja midis stacioneve fikse radio, te vendosur ne pika te caktuara sakte gjeografikisht.

Lidhjet fikse radio perdoren pergjithsisht per transmetime me shpejtesi te madhe midis dy pikave fikse dhe zakonisht vendosja e tyre ne perdorim behet ne ato raste kur perdorimi i tyre eshte me ekonomik ose me i mundshem se i disa menyrave te tjera te transmetimit p.sh me kabell ose me F.O.

Perdoruesit e lidhjeve fikse radio jane te shumte: Operatoret publike te sherbimeve telefonike fikse dhe te levizshem, operatoret radiotelevizive, sipermarresit e ofrimit te sherbimeve publike dhe te sherbimeve te emergjences. Pergjithsisht keta sipermarres perdorin lidhjet radio fikse per te siguruar lidhjen midis pikave te rrjetit te tyre te transmetimit apo realizimin e aksesit te perdoruesve. Sistemet e perdorimit te lidhjeve fikse radio jane Pikë për Pike (P-P) dhe ato Pike Shume Pika (PMP).

Aktualisht, pagesat për lidhjet fikse radio Pikë për Pike (P-P) dhe ato Pike Shume Pika (PMP), jane vjetore dhe ne vlera si me poshte:

Sistem radio-rele nje drejtimshme ( P-P):	25,000.00 Leke/ne vit.
Sistem radio-rele dy drejtimshme ( P-P):	75,000.00 Leke/ne vit.
Sistem radio-rele dy drejtimshme ( PMP):	50,000.00 Leke/ne vit

Keto pagesa nuk marrin parasysh asnje faktor si p.sh brezin e frekuencave, gjeressin e kanalit te frekuencave radio, polarizimin e antenes,etj, numrin e kanaleve te frekuencave radio ne perdorim nga i njejti sipermarres, ne te njejtin drejtim lidhjeje etj. Shumica e lidhjeve fikse radio, kane ne perdorim kanale radio me gjeresi me te madhe se 3.5 MHz, dhe struktura e mesiperme e pagesave nuk stimulon zvogelimin e gjereses se kanalit radio, qe arrihet nga perdorimi i pajisjeve radio me efektivitet lidhur me spektrin e frekuencave.

## PROPOZIMI:

Objektivi kryesor i AKEP, për lidhje fikse radio, është që t'i jap shtyese perdorimit të ketyre lidhjeve radio, si një mjet që lehtëson hyrjen e operatoreve të rinj në tregun e komunikimeve elektronike, krahas perdorimit të infrastrukturave alternative ( linja me qera apo FO)

Kerkesat e sipërmarresve ekzistues, për të vendosur në përdorim lidhje të reja fikse radio, apo për të rritur kapacitetet e transmetimit radio, në drejtime të caktuar, diktojnë inkurajimin e menyrave të tjera efektive të transmetimi, sic është ai me FO, për të bërë të mundur futjen e operatoreve të rinj.

Një objektivi tjetër i AKEP është të nxisë përdorimin e pajisjeve radio që kanë efikasitet të lartë të perdorimit të spektrit. Kjo, vecanerisht, është e rëndësishme në drejtimet dhe vendet e instalimit ku ka një përqendrim të lartë të pajisjeve të lidhjeve fikse radio, sidomos të atyre që përdorin brezat e frekuencave, të caktuar për përdorim me kapacitet të lartë transmetimi dhe për distanca të gjata lidhjeje.

### Pyetje

*Pyetja 7. Cilat janë pikëpamjet tuaja për objektivat e deklaruar të AKEP lidhur me spektrin, për të lehtësuar hyrjen në treg dhe për të përdorur alternativa të tjera të infrastruktures; për të inkurajuar përdorimin e fibrave nga operatorët ekzistues, kerkesat e të cilëve për kapacitete transmetimi janë rritur në atë masë, duke bërë që fibra optike të jete një alternativë e mundshme, dhe për të inkurajuar përdorimin e pajisjeve me efikasitet të perdorimit të spektrit?*

*Pyetja 8. Cilat janë pikëpamjet tuaja mbi pagesat e përdorimit të spektrit për të arritur këto objektiva?*

*Pyetja 9. A ka objektiva të tjera apo konsiderata që ju mendojnë se AKEP duhet të marrë parasysh kur të përcaktoje pagesat për lidhjet fikse radio?*

Me qëllim arritjen e ketyre Objektiveve, AKEP, për pagesat për përdorimin e frekuencave, për lidhjet fikse radio,

### Propozon:

1. Pagesa për lidhjet radio të llogaritet sipas formulës:

**Pagesa vjetore e një lidhje fikse radio [leke] = Pagesa baze x kF x kB,**

Ku:

a) Pagesa baze është: **10,000.00** leke.

b) kF ( Koeficient i Brezave të Frekuencave): kF ndikon në përdorimin optimal të brezave të frekuencave. Ky koeficient merr vlerë, që reflekton cilesitë e brezave të ndryshme të frekuencave radio (brezat e ulët të frekuencave, përdoren për gjatësi të mëdha të

lidhjeve radio dhe me kapacite te larte transmetimi, kurse ato te siperme, perdoren per distanca te shkurtra lidhje radio).

- c) kB ( Koeficient i gjeresi se kanalit): kB ndikon ne perdorimin eficient te spektrit te frekuencave. Ky koeficient merr vlera ne vartesi te gjereses se kanalit te radiofrekuences. ( Kanalet e frekuencave radio me gjeresi te madhe kane pagese me te madhe se kanalet me gjeresi te vogel).

2. Pagesa per nje lidhje radio, e cila ne nje drejtim te caktuar, perdoret me te dy polarizimet horizontal (H) dhe vertical (V), do te jete e njejte si dhe ne rastin kur perdoret me nje polarizim. Kjo do te thote se sipermarresi mund te dyfishoje kapacitetin e transmetimit, nderkohe qe perdor vetem nje kanal te frekuencave radio. Kjo ka per qellim te inkurajojë perdorimin efikas te spektrit dhe te nxis sipermarresit qe kane lidhje te shumefishta ne te njëjtën drejtim radio, të marrin në konsideratë perdorimin e të dy polarizimeve H dhe V të të njëjtës frekuence.

3. Pagesat per lidhjet radio Pike Shume Pike –PMP, do te llogaritet me **4 fishin** e shumes se pageses te nje lidhjeje fikse radio pike-pike, P-P. Ky propozim rrjedh nga fakti se ne lidhjet radio PMP, kemi zone me te madhe, per te cilen, sipermarresit duhet t'i sigurohet mbrojtja nga interferencat e perdoruesve te tjere dhe ne ate zone, kanali i frekuences radio, qe ai ka ne perdorim, nuk mund t'i jepet nje perdoruesi te dyte.

4. Pagesa per caktim e frekuencave te lidhjes fikse radio per cdo aplikim te ri, modifikim dhe rinovim te Autorizimit Individual per perdorimin e frekuences eshte **1.000 leke**.

5. Propozimet per pagesat vjetore te lidhjeve fikse P-P jepen ne tabelen e meposhteme:

**Pagesa Baze 10.000 leke**

**Tabela 2**

Brezi Frekuencave	kF	Gjerresi kanali [ BW]			
		BW ≤ 3.5 MHz	3.5 < W ≤ 20MHz	20 < W ≤ 40MHz	BW > 40MHz
		kB			
		2	2.6	3	4
F ≤ 1 GHz	2.5	50.000	--	--	--
1GHz < F ≤ 17 GHz	3	60.000	78.000	90.000	120.000
17 GHz < F ≤ 37 GHz	2.5	50.000	65.000	75.000	100.000
37GHz < F ≤ 39.5 GHz	2	40.000	52.000	60.000	80.000
F > 39.5GHz	0.5	10.000	13.000	15.000	20.000

6. Ne rastin e lidhjeve **njedrejtimsh**e Pike-Pike (**P-P**) pagesat do te jene sa gjysma e pagesave te dhena ne tabelen e mesiperme Tabela 2.

7. Kur autorizimi individual jepet per një pjesë të një vitit, pagesa për perdorimin e frekuencave llogaritet si vijon:

$$C = A \times (B/12)$$



Ku :

A - pagesa perkatese vjetore, llogaritur sipas Tab 2.

B- numri i muajeve te vitit, gjate te cileve autorizimi eshte i vlefshem. Kur autorizimi eshte dhene per nje periudhe me te vogel se muaj, per qellim llogaritje, ai do te konsiderohet si nje autorizim qe leshohet per nje periudhe nje mujore.

C- pagesa e llogaritur për tu paguar.

8. Llogaritja e pagesave, per lidhjen fikse radio te modifikuar apo te ndryshuar, per perdorim deri ne perfundim te vitit kalendarit, do te behet proporcionalisht me afatin e vlefshmerise se perdorimit, per muaj, bazuar ne pagesen vjetore. Vlera e pageses vjetore te ketyre lidhjeve fikse radio, te modifikuar apo te ndryshuar, do te krahasohet me ate qe eshte kryer ne fillim te vitit, per lidhjet ekzistuese. Kur vlera e pageses se lidhjes radio te modifikuar apo te ndryshuar, eshte me madhe se ajo e fillimit te vitit, subjekti duhet te paguaje diferencen. Kur vlera e pageses se lidhjeve radio te modifikuar apo te ndryshuar, eshte me vogel se ajo e fillimit te vitit, subjekti nuk do te ribursohet per diferencen.

Duke krahasuar pagesat e Tabela 2, me pagesat aktuale, per nje lidhje fikse radio, shihet se, ne disa raste pagesat e propozuara janë më te ulta, ndersa në disa të tjera, rritja e pagesave mendojme se eshte në përputhje me objektivat e AKEP për lidhje fikse radio.

Duhet të theksohet se përveç propozimeve per pagesat e reja ne AKEP , po punon per hartimin e udhezimeve, kerkesave dhe kushteve teknike, bazuar ne rekomandimet e institucioneve nderkombetare, per perdorimin e spektrit te frekuencave per lidhjet fikse radio. Përveç kësaj AKEP do të shqyrtojë përdorimin e spektrit të caktuar për lidhjet fikse, per te krijuar nje tablo reale mbi efektivitetit e ketyre lidhjeve radio. Kjo mund të çojë në ndryshime në zonat me dendesi te madhe te lidhjeve radio.

## **Pyetje**

***Pyetja 10. Cilat janë pikëpamjet tuaja mbi procesin e pajisjes me AI per perdorimin e frekuencave per lidhjet fikse dhe per pagesat e propozuara?***

***Pyetja 11. Cfare mendimi keni per propozim, për të aplikuar një tarifë të vetme ku të dyja polarizimet H dhe V janë vendosur në të njëjtën lidhje radio dhe të njëjtën frekuencë?***

***Pyetja 12. A pajtoheni me propozimin për të aplikuar një pagese per lidhjen PMP, 4 here me te madhe se pagesa e lidhjes P-P? Nëse nuk pajtoheni, cila eshte alternativa qe ju propozoni?***

***Pyetja 13. A pajtoheni me propozimin për të aplikuar një pagese per lidhjen fikse radio nje drejtimshe 2 here me te vogel se pagesa e lidhjes fikse perkatese dydrejtimshe? Nëse nuk pajtoheni, cila eshte alternative qe ju propozoni?***

***Pyetja 14. A keni ndonje mendim tjetër që duhet te merret ne konsiderate nga AKEP?***

## 4.6 Sherbimi radio FWA/BWA

Elementi më i vështirë për tu ndërtuar dhe me kosto të lartë, i një rrjeti të komunikimeve elektronike është rrjeti lokal i aksesit. Aktualisht, rrjeti tradicional i lidhjeve kabllorë me përcjellës, përveçse zëvendësimi me kabllorë me fibra optike, po zëvendësohet dhe me pajisjet radio. Sistemet Fixed Wireless Access (FWA)/ BWA (Broadband Wireless Access) janë mjetet më të mira për të zëvendësuar strukturën aktuale me linja kabllorë. FWA/BWA është konsideruar shumë herë si Fixed Wireless Access Point to Multipoint (FWPMA), por shërbimet e këtij rrjeti mund të derdohen nëpërmjet lidhjeve radio Pik-Pike, dhe në zona me të gjera gjeografike.

Sistemet FWA/BWA, jo vetëm konkurojnë rrjetet kabllorë lokale (lidhur me kohën e vendësimit dhe koston), por kanë mundësinë të ofrojnë shërbime komunikimi elektronik, me brez të gjërë (Broadband) dhe në shtrirje gjeografike më të mëdha se lokale/rajonale deri kombëtare.

Bashkëzotuesit e disa infrastrukturave (linja kabllorë me përcjellës dhe FO, lidhjet satelitore, DSL) rrit konkurrencën, e cila çon në përfitimet e përdoruesit të shërbimeve, për të marrë shërbime më të mira dhe me çmime konkurruese.

AKEP ka stimuluar përdorimin e brezave të frekuencave, që janë të përjashtuar nga pajisja me autorizim individual, për ofrimin e shërbimeve me brez të gjërë, në disa nga qytetet kryesore të vendit.

AKEP, së shpejti, për brezat e frekuencave të përcaktuara për shërbimet FWA/BWA, në Planin Kombëtar të Frekuencave Radio, të fillojë procedurat e parashikuara në Ligj për pajisjet me autorizim përdorimin e këtyre brezve të spektrit radio.

Deri tani nuk ka pasur pagesa për shërbimet FWA/BWA.

### **Propozim:**

1. Kane kuptim dy lloje autorizime për përdorimin e brezave të frekuencave FWA/BWA.
  - a) Për zona lokale/rajonale; dhe
  - b) Kombëtare.
2. Pagesat vjetore për këto autorizime të jenë:

#### **a) Zona Lokale/rajonale:**

Pagesa për pajisjen me Autorizim individual për përdorimin e frekuencave të brezi 2,3 GHz , 3.5 GHz, 10.5 GHz dhe 26 GHz. dhe për çdo rinovim të tij do të jenë si vijon:

Gjersia e brezi	Pagesa ne Leke
$B \leq 7$ MHz	200.000 leke
$7 \text{ MHz} < B \leq 14$ MHz	400.000 Leke
$14 \text{ MHz} < B \leq 28$ MHz	600.000 leke

**b) Kombetar:**

Brezi i frekuencave	Pagesa ne Leke per cdo 1 MHz gjeresi brezi
2.0 - 2.3 GHz	60.000 leke
3.41 – 3.8 GHz	80.000 leke
10.1 – 10.7 GHz	60.000 leke
24.5 – 26.5 GHz	50.000 Leke

9. Kur autorizimi individual jepet për një pjesë të një vitit, pagesa për përdorimin e frekuencave llogaritet si vijon:

$$C = Ax (B/12)$$

Ku :

A - pagesa perkatese vjetore, sipas gjeresise se brezit te dhene per përdorim,

B- numri i muajeve te vitit, gjate te cileve autorizimi eshte I vlefshem. Kur autorizimi eshte dhene per nje periudhe me te vogel se nje muaj, per qellim llogaritje, ai do te konsiderohet si nje autorizim qe leshohet per nje periudhe nje mujore.

C- pagesa e llogaritur për tu paguar.

10. Llogaritja e gjeresise se brezit do te behet duke marr ne konsiderate te dy pjeset e brezit ne rastin FDD, dmth per brez 2x5 MHz, ne dispozicion te sipermarresit, llogaritja e pageses do te behet me brez me gjeresi 10 MHz.

**Pyetje:**

*Pyetja 15 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per ndarjen ne zonat lokal/rajonal ?*

***Pyetja 16 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per pagesat per perdorimin e frekuencave per autorizimet perkatese ?***

#### **4.7 Sherbimet Satelitore**

Shërbimet satelitore perfshijne: Sherbimin fiks satelitor dhe sherbimin e levizshem satelitor. Ky sherbim luan nje rol te rëndesishem ne sherbimin aeronautik dhe detar duke siguruar sherbime te tilla si navigacion, radar dhe sherbimin e pozicionit global (GPS).

a) Sherbimi fiks satelitor (Fixed-Satellite Service - FSS)

Shërbimi fiks satelitor (FSS) perben një pjesë të rëndësishme të rrjeteve të komunikimeve elektronike. Sherbimi FSS është i përshtatshme për kryerjen e komunikimit në një zonë të gjerë dhe luan rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike me brez të gjere, tek perdoruesit ( DTH- direkt-to-home ) duke perdorur stacione te vegjel te instaluar ne toke, te quajtur terminale te konsumatorit.

b) Sherbimi i levizshem satelitor (Mobile-Satellite Service -MSS)

Sherbimi i levizshem satelitor aplikohet ne sherbimin e levizshem tokesor (terminal-terminal) nepermjet lidhjes satelitore Toke-Satelit, Shërbimin e levizshem detar dhe ate aeronautik. Dy sherbimet e fundit te levizshem satelitor (detar dhe aeronautik), pervec komunikimeve te zakonshme elektronike (zanor, transmetim te dhena, faks, mesazhe) qe ofrojne rrjetet e levizshme tokesor te komunikimit ( GSM, UMTS), ofrojnë dhe sherbimet e rëndesishme qe lidhen me sistemet e sigurisë e fatkeqsisë ne sherbimin detar (Global Maritime Distress Safety System - GMDSS).

Transmetimit me satelit i programeve te radios dhe televizionit, i quajtur shpesh direkt ne shtepi (Direct-To-Home -DTH) ose transmetim direkt me satelit (Direct Broadcasting by Satellite - DBS) realizohet me instalimet e thjeshtë te nje marresi me antenë të vogël, që kërkon një sinjal të fortë nga sateliti. Ky lloj sherbimi ka aktualisht nje perdorim te gjere.

- Stacion Satelitor Fiks Tokesor (Fixed Satellite Earth Stacione –FSES);  
dhe
- Sisteme Stacion Satelitor Fiks Tokesor ( njihen dhe me emertimin Teleport Facility licences) Stacion Satelitor Fiks Tokesor FSES ndahen ne dy kategori:
  - Stacione Satelitor Tokesor Fiks (Fixed Earth Stacione -FES) ku përfshihen stacionet e marrjes në tokë dhe VSAT ( Very Small Aperture Termialet -VSAT));

dhe

- Stacionet Tokesor Satelitor te transportueshëm.

a) Stacion Satelitor Fiks Tokesor ( Fixed Earth Stacione - FES)

FES janë stacione toke përdorur në vende të caktuara dhe të cilat janë te pa transportueshëm. Ato përfshin stacionet tokë që veprojnë:

- në shërbimin satelitor fikse (FSS) në frekuenca më e madhe se 3GHz;
  - si një lidhje furnizues në shërbimin satelitor celular (MSS) në frekuenca më të madhe se 3GHz;
- ose
- si një lidhje për shpërndarjen, transmetimin e programeve Radio Televizive nepermjet satelitit-BSS (Broadcasting Satellite Service -BSS) në frekuenca me te madhe se 3GHz.

#### b) Stacionet Tokesor Satelitor te transportueshëm (Transportable Earth Stations -TES)

TES janë stacione që përdoren për të transmetuar informacione nga vende të ndryshme. Janë të transportueshëm dhe zakonisht emertohen SNG – Satellite News Gathering Stations. TES mund të veprojnë në vende të ndryshme ose të qëndrojnë në një vend të caktuar gjatë gjithë aktivitetit. TES zakonisht mund të jetë montuar ne automjete.

#### c) Sistem Stacionesh Satelitor (Teleport).

Sistem Stacionesh Satelitor (Teleport) perbejne dy ose më shumë Stacionet Tokesor Satelitor Fiks (jo te transportueshëm, të cilet bashkërisht sigurojnë komunikimet elektronike brenda rrjetit, dhe të cilat janë të vendosura në vende te caktua, te cilet bashkërisht janë të aftë për të transmetuar, ne te njejten kohe, në më shumë se një frekuence me me shumë se një Stacion Hapësirë ne të njëjtën kohë duke përdorur antena me aftesi drejtimi automatik.

#### Brezat e Frekuencave.

Plani Kombëtar i Frekuencave Radio , referuar RR te ITU ka percaktuar brezat e frekuencave qe perdoren per sherbimin satelitor.

Shumica e brezave te frekuencave te caktuar per sherbimin satelitor jane per perdorim te perbashket me sherbime te tjera radio ( lidhje fikse radio, SDR etj). Per kete arsye caktimi i nje frekuence pune per lidhje satelitore do kerkoje koordinimin kombetar dhe nderkombetar per te mos ndikuar ne sherbimet e tjera radio.

Brezat e frekuencave **per perdorim ekskluziv** per SES janë:

- 12,5-12,75 GHz; dhe
- 14,0-14,25 GHz.

Pagesat aktuale per sherbimet satelitore jane:

Stacion satelitor fiks	: 150.000 leke / ne vit
Sistem satelitor VSAT	: 15.000 leke/ ne vit per cdo terminal VSAT

- Terminal satelitor i levizshem : 5.000 leke / ne vit  
 Stacion tokesor i levizshem (SNG) :
- a) 1.000 USD/ per 1 jave; dhe 500 USD per cdo jave vijuese;
  - b) 2.000 USD/ per license me vlefshmeri 1(nje) mujore.
  - c) 5.000 USD/ per license me vlefshmeri 3(tri) mujore.

AKEP per pagesat per Stacionet Satelitore Tokesor Fiks, mendon qe te merren ne konsiderate brezi i frekuencave, fuqia ekuivalente isotropike e rezatuar EIRP dhe gjeresia e brezit. Perdorimi i lidhjeve satelitore ne brezin e frekuencave qe jane per perdorim ekskluziv do te merret ne konsiderate ne percaktimin e pagesave relativisht me te uleta se ne brezat e tjere te spektrit te frekuencave, prandaj,

**Propozon:**

1. Kur autorizimi individual per perdorimin e frekuences ka vetem nje Stacion Satelitor Tokesor Fiks, fuqia EIRP, e te cilit eshte me e madhe se 50 dBW ( EIRP > 50 dBW ) dhe frekuenca e punes eshte ne nje apo te dy brezat e frekuences te **perdorimit ekskluziv**:

**(12,5-12,75) GHz dhe (14,0-14,25) GHz,**

dhe operon me nje Stacion te vetem te Hapsire, atehere,:

- a) Pagesa vjetore dhe do te jete : 20.000 leke, kur i licensuari ka ne sistem deri ne 10 stacione te tjere satelitor fikse.
- b) Dhe do te paguaje nje shtese prej : 3.000 leke per cdo Stacion Satelitor Tokesor Fiks shtese nga sasia qe percakton pika 1.a, me lart.

2. Kur Stacion Satelitor Tokesor Fiks perdor nje frekuence pune te ndryshme nga ato te brezave te frekuencave te dhena ne pika 1.a, me lart, pra **frekuenca te brezave jo ekskluziv**, dhe kjo frekuence eshte ne brezat e frekuences me te madhe se 3 GHz ( f>3 GHz), dhe ky Stacion Satelitor Tokesor Fiks, operon me nje Stacion te vetem Hapsinor, atehere pagesa vjetore, do te varet nga gjeresia e spektrit te frekuencave te perdorur, fuqia EIRP e transmetimit dhe brezi i frekuencave.

Pagesa vjetore do te llogaritet sipas Tabeles se meposhteme dhe shenimeve qe jepen ne vazhdim te saj:

- a) Stacion Satelitor Tokesor Fikse, me frekuence pune ne brezin (3-10) GHz, per gjeresi te ndryshme te spektri radio ne perdorim, do aplikohen keto pagesa:

(i) Kur fuqia EIRP eshte  $\leq 50$  dBW:

Gjeresi e brezit	Pagesa Leke
BW $\leq 500$ kHz	100.000

$500 \text{ kHz} < BW \leq 2 \text{ MHz}$	125.000
$2 \text{ MHz} < BW \leq 11 \text{ MHz}$	150.000
$11 \text{ MHz} < BW \leq 40 \text{ MHz}$	175.000
$40 \text{ MHz} < BW \leq 80 \text{ MHz}$	200.000
$BW > 80 \text{ MHz}$ , për cdo 1 MHz, gjerësi brezi ose pjesë të tij	$200.000 + (BW - 80) \times 3.000$

(ii) Kur fuqia EIRP është  $50 < P \leq 75 \text{ dBW}$ , pagesat për gjerësitë e brezit, sipas Tabelës së mësipërme do të rriten, përkatësisht me 25.000 Leke

Gjerësi e brezit BW	Pagesa Leke
$BW \leq 500 \text{ kHz}$	125.000
$500 \text{ kHz} < BW \leq 2 \text{ MHz}$	150.000
$2 \text{ MHz} < BW \leq 11 \text{ MHz}$	175.000
$11 \text{ MHz} < BW \leq 40 \text{ MHz}$	200.000
$40 \text{ MHz} < BW \leq 80 \text{ MHz}$	225.000
$BW > 80 \text{ MHz}$ , për cdo 1 MHz, gjerësi brezi ose pjesë të tij,	$225.000 + (BW - 80) \times 3.000$

(iii) Kur fuqia EIRP është  $P > 75 \text{ dBW}$ , pagesat për gjerësitë e brezit, sipas Tabelës së mësipërme do të rriten, përkatësisht me 50.000 Leke

Gjerësi e brezit BW	Pagesa Leke
$BW \leq 500 \text{ kHz}$	150.000
$500 \text{ kHz} < BW \leq 2 \text{ MHz}$	175.000
$2 \text{ MHz} < BW \leq 11 \text{ MHz}$	200.000
$11 \text{ MHz} < BW \leq 40 \text{ MHz}$	225.000
$40 \text{ MHz} < BW \leq 80 \text{ MHz}$	250.000
$BW > 80 \text{ MHz}$ , për cdo 1 MHz, gjerësi brezi ose pjesë të tij,	$250.000 + (BW - 80) \times 3.000$

- b) Stacion Satelitor Tokesor Fikse, me frekuencë punë në brezin (10-15) GHz, pagesat vjetore të llogaritura sipas pikës (i), (ii) dhe (iii) do të zvogelohen me 50.000 Leke.
- c) Stacion Satelitor Tokesor Fikse, me frekuencë punë në brezin (15-20) GHz, pagesat vjetore të llogaritura sipas pikës (i), (ii) dhe (iii) do të zvogelohen me 65.000 Leke.
- d) Stacion Satelitor Tokesor Fikse, me frekuencë punë në brezin (20-30) GHz, pagesat vjetore të llogaritura sipas pikës (i), (ii) dhe (iii) do të zvogelohen me 75.000 Leke.
- e) Stacion Satelitor Tokesor Fikse, me frekuencë punë në brezin (20-30) GHz, pagesat vjetore të llogaritura sipas pikës (i), (ii) dhe (iii) do të zvogelohen me 90.000 Leke.

3. Kur autorizimi individual jepet për të përdorur një Stacion Satelitor Tokesor Fikse, që vepron në një stacion të vetëm hapësirë, për një pjesë të një viti, deri në dymbëdhjetë muaj, atëherë pagesa do të llogaritet si vijon:

$$C=A \times (B / 12)$$

Ku:

C – është shuma në Leke e pageses, për përdorimin e Stacion Satelitor Tokesor Fikse

A - është pagesa vjetore e llogaritur sipas Pikes 1. ose Pike 2, të dhëna më lartë.

B - është numri i muajve të plote për të cilën autorizimi individual është i vlefshëm.

Nëse autorizimi individual jepet për një periudhë më të vogël se një muaj, për qëllim të llogaritjes së pageses, autorizimi do të konsiderohet i lëshuar për një periudhë prej 1 (një) muaji.

### 3. Pagesa për Teleport.

- a) Pagesa vjetore për autorizimin individual për sistem Teleport do të llogaritet si shumë e pagesave vjetore të llogaritura për çdo Stacion Satelitor Tokesor Fikse, që përmban Teleporta, dhe varet nga gjëresia e spektrit radio të përdorur, nga secili Stacion Tokesor.

Pagesat vjetore në vartësi të gjëresisë së spektrit të përdorur, për një vit, jepen në tabelën në vijim:

Gjëresia e brezit BW	Pagesa Leke për 1 vjet (12 muaj)
$BW \leq 500 \text{ kHz}$	600.000
$500 \text{ kHz} < BW \leq 2 \text{ MHz}$	700.000
$2 \text{ MHz} < BW \leq 11 \text{ MHz}$	900.000
$11 \text{ MHz} < BW \leq 40 \text{ MHz}$	1.000.000
$40 \text{ MHz} < BW \leq 80 \text{ MHz}$	1.500.000
$BW > 80 \text{ MHz}$ , për çdo 1 MHz, gjëresia e spektrit ose pjesë të 1 MHz.	$1.500.000 + (BW - 80) \times 15.000$

- b) Për çdo shtesë në numrin e Stacioneve Satelitor Tokesor Fikse, pagesa vjetore do të shtohet me 150.000 leke.

- c) Për çdo shtesë në numrin e Stacioneve Satelitor Hapsinor, për të siguruar komunikimin me një apo me shumë Stacione Satelitor Tokesor Fiks të sistemit, pagesa vjetore do të shtohet me 150.000 leke.

### Pyetje:

***Pyetja 17 : Cili është mendimi juaj për propozimet e mesipërme për dhënie të Autorizimeve individual për lidhjet satelitore?***

***Pyetja 18 : Cili është mendimi juaj për propozimet e mesipërme për pagesat për lidhjet satelitore ?***

### **4.8 Licensat radio të anijeve**

Pajisje Radio që përdoren në bordin e anijeve përdorin spektrin e harmonizuar ndërkombëtar. Në bazë të Ligjit AKEP është i detyruar të plotësojë dhe të veprojë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare. Këto detyrime lidhen me caktimin Shenjës dhe Thirrjes së anijeve, kodin MMSI



dhe përditësimin e tyre në bazën e të dhënave të institucioneve ndërkombëtare. AKEP bashkepunon me Kapitenerinë e Përgjithshme të Portit dhe Regjistrin Detar për të siguruar që pajisjet radio, të nevojshme dhe të domosdoshme për aktivitetin e anijes gjatë lundrimit, janë në sasi dhe llojshmeri, sipas zonës së veprimtimit të anijes, dhe plotësojnë parametrat teknike të standardeve përkatëse.

Pagesa vjetore është 7.500 leke me të drejtë rinovimi çdo vit.

AKEP me qëllim reduktimin e vonësive administrative dhe aplikimin e një pagese që reflekton me saktë koston e leshimit të një License Radio Anije.

### **Propozon:**

- a) Licença të mos ketë afat vlefshmerie, por të zgjaset për atë kohë sa anija të jetë në aktivitet;
- b) Pagesa të jetë vetëm një herë, e menjëherëshme, në masën 15000 leke.
- c) I Licensuari çdo 5 (pesë) vjetë të konfirmojë në AKEP, të dhënat e sistemit radiokomunikimit, që AKEP të sigurojë dhe përditësojë në Bazën e tij të të dhënave, të dhënat e sakta për Licencat Radio të anijeve që janë në aktivitet.
- d) Në rast se i Licensuari nuk bën këtë konfirmim Licença Radio e anijes revokohet.
- e) Amendimet e licencave duke përfshirë dhe transferimin e Licencave, ndërmjet dy pronarëve të anijes, do të lejohet me kushtin që Shenja e Thirrjes dhe kodi MMSI do të mbeten të pandryshuara, pra ata të fillimit, dhe se janë plotësuar dhe kushtet e tjera si pajisja me Certifikatën e radio detarit.
- f) Pagesa për ndryshimin (modifikimin) dhe transferimin e Licencave që do të jetë 5.000 leke.
- g) Pagesa për Shenje Thirrje të Anijes dhe Kodin MMSI, do të mbetet e pandryshuar, siç janë aktualisht: secila nga 2.500 leke dhe do të aplikohen vetëm një herë.

### **Pyetje:**

*Pyetja 19. Cilat janë pikëpamjet tuaja në skemën e licencimit të propozuar për licencat e radio anije dhe pagesat lidhur me to?*

*Pyetja 20. : Cilat janë pikëpamjet tuaja mbi propozimin për të lejuar transferimin e licencave radio të anijeve midis pronarëve?*

*Pyetja 21. A ka ndonjë qasje tjetër që ju mendoni se duhet të merren parasysh?*

## **4.9. Licencat radio të avionave**

Pajisje Radio që përdoren në bordin e avionave përdorin spektrin e harmonizuar ndërkombëtar. Në bazë të ligjit, AKEP është i detyruar të plotësojë dhe të veprojë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare. Këto detyrime lidhen me caktimin Shenjës e Thirrjes së Avionit.

Para pajisjes me License Radio te Avionit, AKEP bashkepunon me Drejtorin e Pergjithshme te Aviacionit per tu siguruar qe pajisjet radio, te nevojshme dhe te domosdoshme per aktivitetin e avionit, jane ne sasi dhe llojshmeri, dhe plotesojne parametrat teknike te standardeve perkatese.

Pagesa vjetore aktualisht eshte 10.000 leke me te drejte rinovimi cdo vit.

AKEP, duke patur parasysh ngjashmerine midis Licenses Radio te Avionit me te Licenses Radio te Anijes, mendon nje strukture te ngjashme pagese, prandaj,

### **Propozon:**

- a. Licensa te mos kete afat vlefshmerie, por te zgjase per aq kohe sa avioni te jete ne aktivitet;
- b. Pagesa te jete vetem nje here, e menjehere, ne masen 15.000 leke.
- c. I Licensuasi cdo 5 (pese) vjete te konfirmoje ne AKEP, te dhenat e sistemit radiokomunikimit, qe AKEP te perditesoje ne Bazen e te Dhenave, te dhenat e sakta per Licensat Radio te Avionave, qe jane ne aktivitet.
- d. Ne rast se i Licensuari nuk bene kete konfirmin Licensa Radio e Avionit, revokohet.
- e. Amendimet e licenses duke perfshire dhe transferimin e Licenses, ndermjet dy pronareve te avionit, do te lejohet me kushtin qe Shenja e Thirrjes dhe kodi MMSI te mbeten te pandryshuara, pra ata te fillimit.
- f. Pagesa per ndryshimin (modifikimin)dhe transferimin e Licenses qe do te jete 5.000 leke.
- g. Pagesa per Shenje Thirrje te Avionit, do te mbetet e pandryshuar, sic eshte aktualisht: 2.500 leke dhe do te aplikohen vetem nje here.

### **Pyetje:**

***Pyetja 22. Cilat jane pikëpamjet tuaja në skemën e propozuar për licensen radio te avionit dhe pagesat që lidhen me te'?***

***Pyetja 23. A ka ndonjë qasje tjetër që ju mendoni se duhet të meret parasysh?***

### **4.10 Autorizimet individuale per qellime kerkimi, matjeje dhe prove**

AKEP me qellim inkurajimin e inovacionin dhe zhvillimin e teknologjive te reja, per qellime kerkimi, matjeje dhe prove te pajisjeve te radiokomunikimit, ka pajisur dhe do te vazhdoje te pajise me Autorizim Individual per perdorimin e frekuencave, subjektet ofrues te sherbimeve komunikimeve elektronike, operatore te rrjeteve te komunikimeve elektronike si dhe subjekteve tregtare te ketyre pajisjeve. Bazuar ne Ligjin 9918 Neni 72, pika 3 afati i vlefshemrise se ketyre autorizimeve individuale do te jete i perkohshem, deri ne 90 dite.

Autorizimet Individuale per qellime kerkimi, matjeje dhe prove te pajisjeve te radiokomunikimit kanë të bëjnë vetëm me kryerjen e provave të pajisjeve te reja radio dhe per sherbimet te ndryshme radio, qe i ofrohen publikut.

Keto pajisje, pas kryerjes se testimit dhe eksperimentimit, mund të rezultojne te papershtatshme, per tu vendosur ne perdorim, prandaj ato nuk do te lejohen te perdoren pas perfundimit te testit dhe subjekti nuk do te pajiset me AI per perdorimin e tyre.

Per kete arsye Formulari i aplikimit si dhe autorizimi individual, per keto lloje sherbimesh radio, do te jene te ndryshme nga ata qe perdoren per sherbimet e tjera radio.

AKEP, me kete dokument konsultimi, per keto lloje sherbimi radio,

### **Propozon:**

- a. Autorizimi individual per qëllime kërkimi, matjeje dhe prove të pajisjeve të radiokomunikimit te jete me afat vlefshmerie deri 90 dite, pa mundesi rinovimi (zgjatje) te ketij afati per qellimet e mesiperme;
- b. Pagesa per AKEP te jete e menjehereshme per gjithë periudhen e caktuar per testim.
- c. Llogaritja e pageses do te behet bazuar ne pagesen vjetore te sherbim perkates radio. Ajo do te jete proporcinale me kohen e vlefshmerise se AI, por nuk do te jete me vogel se 15.000 leke/per muaj per cdo kanal te caktuar.
- d. Pagesa per caktim e frekuences/ave, per cdo aplikim per Autorizimit Individual per perdorimin e frekuences, per qëllime kërkimi, matjeje dhe prove të pajisjeve të radiokomunikimit eshte 1.000 leke. Kur aplikimi paraqitet me postë, pagesa prej 1000 lekesh do te merret ne momentin e kryerjes se llogaritjeve te detyrimeve financiare.

### **Pyetje:**

***Pyetja 24. Cilit eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme, lidhur me afatin e vlefshmerise se Autorizimit Individual dhe pagesen per perdorimin e frekuencave per kete sherbim radio.***

#### **4.11 Autorizime individual per ngjarje te vecanta.**

AKEP , bazuar ne Nenin 72, pika 4) te ligjit 9918, mund te leshojje autorizime individuale per perdorimin e frekuencave per ngjarje te vecanta për një periudhe kohore jo më shumë se 60 ditë.

Ky lloj autorizimi individual u jepet individeve dhe kompanive te perdorin perkohesisht pajisjet radio per qellim te marrjes dhe dergimit te mesazheve qe lidhen me nje aktivitet te caktuar si koncerte artistike, aktivitete sportive etj. Keto pajisje mund te jene stacione radio komunikimi ne brezat VHF, UHF, kamera televizive si dhe pajisje te telemetrise qe perdoren per transmetimin e te dhenave.

- a) Periudhë maksimale e vlefshmërisë së Autorizimit te Përkohshëm per perdorimin e frekuencave te jete 60 dite.
- b) Autorizimet individuale te ketij sherbimi radio nuk janë te rinovueshem.
- c) Ne se eshte e nevojshme qe vlefshmeria e autorizimit individual te jete me shume se 60 dite (2 muaj), atehere i interesuari duhet te aplikojte duke ju referuar kerkesave te aplikimit per sistem PMR sipas rregullores perkatese ne fuqi. Ne kete rast frekuenca e punes mund te mos jete e njete me ate qe eshte perdorur gjate kohes se zhvillimit te aktivitetit.

**Propozim:**

Pagesa per perdorimin e frekuencave do te jete proporcionale, me kohen ne muaj, me 2 fishin e pageses vjetore te sistemit PMR dhe do te llogaritet si vijon:

$$C = 2 \times [A \times (B/12)];$$

Ku:

- A - pagesa perkatese vjetore, per sistemin PMR.
- B - numri i muajve te vitit, gjate te cileve autorizimi eshte i vlefshem. Kur autorizimi eshte dhene per nje periudhe me te vogel se nje muaj, per qellim llogaritje, ai do te konsiderohet si nje autorizim qe leshohet per nje periudhe nje mujore.
- C - pagesa e llogaritur për tu paguar.

**Pyetje:**

*Pyetja 25 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per sherbimin radio per ngjarje te vecanta.*

**4.12 Shërbimi RadioAmatori**

Ky sherbim qe realizohet me pajisje te personave apo grupeve te caktuar perdoruesish dhe nuk ka qellim fitimi por vetem ate te komunikimit per qellime personale. Sherbimi radioamator perdor spekter te caktuar te frekuencave dhe kryerja e ketij sherbim kerkon pajisjen me Certificate radioamatori dhe Leje Transmetimi.

Aktualisht aplikohen keto pagesa:

- a) Certificate radioamatori : 500 leke vetem nje here.
- b) Leje transmetimi,
  - Radioamator vendas: 200 leke cdo 5 vjet.
  - Radioamatorte huaj:
    - 500 leke per leje 1 javore
    - 1000 leke per leje 3 mujore
    - 2000 leke per leje 6 mujore.

AKEP, nisur nga fakti se pajisjet prodhohen sipas standardeve nderkombetare per kete sherbim radio dhe spektri i perdorur per sherbimin radioamator eshte i harmonizuar ndërkombëtar (per perdorim paresor apo perdorim te perbashket me pergjithsisht per perdorim te perbashket me sherbime te tjera radio) dhe me qellim qe ky sherbim te kete nje perhapje edhe me te madhe,

**Propozon:**

Ruajtjen e nivelit te pagesave aktuale per Certificate Radioamatori dhe Leje Transmetimi.

## **Pyetje:**

*Pyetja 26 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per sherbimin radioamator.*

### **4.13 Pagesa te tjera**

Gjithashtu ne AEP kryen pagesa per Certifikaten e Konformitetit te pajisjeve radio (dhe komunikimi elektronik) dhe per rregjistrim e domain CCTLD.al.

a) Pagesat per Certifikaten e Konformitetit te pajisjeve, qe kryhen vetem nje here, te mbeten te padryshuara,

- Per subjettet tregtare vendase	3.000 leke
- Per subjettet jo tregtare vendase	100 leke
- Per subjettet te huaja	3.000 leke

b) Pagesa per rregjistrim e domain CCTLD.al aktualisht eshte 75 USD cdo dy vjet.

## **Propozim:**

Pagesa vjetore per regjistrimin te jete:

*2,000 leke / cdo vit te plote*

## **Pyetje:**

*Pyetja 27 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per nivelin e pagesave?*

## **5. PAGESAT PER CAKTIMIN DHE PERDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE**

Pagesat, qe kryen aktualisht, per numeracionin ne AKEP, jane ato per caktimin e numerave dhe serive numerike. Keto pagesa kryhen vetem nje here, kur caktohet numri ose serite numerike. Emertesat dhe vleftat e ketyre pagesave percaktohen ne VKM Nr.75, date 6.2.2003-Pika IV- Pagesat per numeracion.

Sipas Ligjit Nr.9918, date 19.05.2008, "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise", Neni 119-Pagesat, Pika 1/ç: *Pagesat, qe kryhen ne AKEP, jane:*

*Pagesa per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe te serive numerike, sipas percaktimeve ne nenin 80 te ketij ligji.*

Pra, pagesat qe do te kryhen ne AKEP per numrat dhe serite numerike do te jene dy, nje pagese per caktimin numrave ose serive numerike, e cila kryhet vetem kur aplikohet per caktimin e numrave dhe serive numerike dhe nje pagese vjetore per perdorimin e numrave dhe serive numerike te caktuara, e cila kryhet per cdo vit sipas nenit 86, pika 3 e Ligjit Nr.9918, date 19.05.2008.

Pagesa per caktimin e numrave ose serive numerike do te jete nje pagese simbolike por e detyrueshme per te filluar aplikimin per numeracion.

Nga dokumentat rregullatore, te konsultuara deri tani, per llogaritjen e pageses vjetore per perdorimin e numrave dhe serive numerike te caktuara, verehet se pagesa vjetore per perdorimin e numeracionit, ndonse ruajne raporte pak a shume te peraferta per sa i perket llojeve te numrave dhe serive numerike, ne vlera absolute kane diferenca te konsiderushme ne rritje. Vlerat e pagesave per perdorimin e numeracionit per zerat e vecante ne pergjithesi jane parashikuar te ulura dhe ruajne nje nivel te perafert me nivelin e pagesave aktuale

Pagesat per caktimin e numrave dhe te serive numerike kryhet bashke me aplikimin e paraqitur nga subjektet fizike ose juridike. Kjo pagese kryhet vetem nje here.

Pagesat per perdorimin e numrave dhe serive numerike eshte vjetore dhe kryhet nga subjektet, pas njoftimit zyrtar te AKEP, brenda afateve kohore te percaktuara ne ate njoftim.

Pagesat per numrat dhe serite numerike, ne rastin e perdorimit te tyre ne vitin pasardhes, duhet te kryhet brenda afateve qe do te percaktoje AKEP.

Pagesat per caktimin e numeracionit (kryhet vetem nje here) dhe perdorimin e numeracionit te caktuar (kryhet cdo vit), sipas llojit, perdorimit dhe gjatesise se numrave, jepen ne tablen bashkengjitur.

**PAGESAT PER CAKTIMIN DHE PERDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE**

(Ne Leke)

Nr.	Emertesa	Pagesa per Caktimin e Numrave dhe Serive Numerike	Pagesa Vjetore per Perdorim te Numr. dhe Serive Num.
1	Numra gjeografike: -Blloqe 1 000 numrash -Blloqe 10 000 numrash	1.000 1.000	2.000 5.000
2	Numra jo-gjeografike per: Sherbimin e Komunikimeve Publike te Levizeshme, Sherbimin Paging (63), Sherbimin e Komunikimeve Personale (700), -Blloqe 1 000 numrash -Blloqe 10 000 numrash	1.000 1.000	2.000 5.000
3	Numra jo-gjeografike per: Sherbimin Free-Phone (800)-numer jeshil, Sherbimet me Ndarje te Kostos (808)-numer blu	2.000	25.000
4	Numra jo-gjeografike per: Sherbimet Data Network, Internet, (717) Rrjeta per Qellime Specifike (711) Sherbimi Posta Zanore (712) Rrjeta Virtuale Private (713)	2.000	25.000
5	Numra jo-gjeografike per: Sherbimet me Ndarje te Ardhurash (900) Sherbimi i Kartes se Parapaguar (801)	2.000	25.000
6	Kode te Shkurter per Sherbimet SMS/MMS me vlere te shtuar (VAS), Formati: 5XXXX (ku X=0 ÷ 9): - numer individual - blloqe 10 numrash	2.000 2.000	20.000 150.000
7	Kode te Shkurter te Harmonizuar ne nivel europian(HESC), Formati: 11X dhe 19X (ku X=0 ÷ 9)	1.000	Pa pagese
8	Kode te Shkurter te urgjencave, Formati: 12X (ku X=5 ÷ 9)	1.000	Pa pagese
9	Kode Aksesit per bartesit, Formati: 10XX (ku X=0 ÷ 9)	10.000	500.000
10	Kode te rrugezimit per Portabilitetin e Numrit, Formati: 99XX (ku X=0 ÷ 9)	2.000	20.000
11	Kode te Pikave Kombetare te Sinjalizimit-NSPC	2.000	20.000
12	Kode te Pikave Nderkombetare te Sinjalizimit-ISPC	10.000	100.000
13	Kode te Rrjeteve Mobile-MCC/MNC	10.000	100.000
14	Kode Identifikimi te Rrjeteve Transmetim te Dhenash-DNIC	10.000	500.000

### Pyetje

*Pyetje28: Cili eshte mendimi juaj per nivelin e pagesave per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike te dhena ne tabelen e mesiperme ?*

### 6. KRAHASIMI I PAGESAVE TE PROPOZUARA ME VENDET E TJERA

## 6.1 Hyrje

AKEP ne kuadrin e rishikimit te pagesave te spektrit, realizoi krahasimin e pagesave aktuale (sipas VKM Nr.75, date 6.2.2003) dhe ato te propozuara, te dhena ne kete dokument, me pagesat e vendeve te tjere.

AKEP, pergjithsisht, ka konstatuar se niveli i pagesave aktuale dhe atyre te propozuara, ne shumicen e rasteve jane me te vogla, se ato aktuale dhe te propozura, ne vendet endryshme te Europes.

Gjithashtu u vrejti se shumica e vendeve, merr ne konsiderate faktore te tille si: gjeresia e kanalit te frekuencave, brezin e brekuencave dhe/ose zonen e mbulimit me sherbimin radio PMR dhe ato te lidhjeve fikse radio.

Ne vijim ju paraqesim krahasimet e pagesave të aplikuara në vende te ndryshme për sisteme të ndryshme radio

## 6.2 Lidhje fikse radio

Në shumicën e vendeve verëhen ulje e pagesave me rritje te brezit te frekuences dhe kjo pagese rritet me rritjen e gjerësi se kanalit te frekuencave radio. Kjo reflekton faktin se gjatesia e lidhjes fikse radio, ne brezat e larta te frekuencave, eshte me e shkurter dhe se zona gjeografike, e mundeshme per interferenca te demshme, ne kete lidhje radio, zvogëlohen. Pagesat per gjerësi e kanalit te frekuences radio inkurajojne perdorimin e pajisjeve me efikasitet te larte te spektrit.

## 6.3 Sherbimi privat i levizshem radio – PMR.

Per kete lloj sherbimi radio, shumë vende bëjnë dallim midis sistemeve on-site dhe sistemeve zonë të gjerë, duke parashikuar midis tyre vendosjen e kategorive te tjera qe percaktohen sipas zones se sherbimit dhe numrit te pajisjeve radio portative ne nje sistem radiokomunikimi.

Sistemi PMR , ne nje zone te vogel mbulimi 3 km dhe /ose nje stacion baze me fuqi maksimale ERP 5 W, eshte rasti, qe ka pagesen me te ulet, duke konsideruar nivelin me te ulet te interferencave, qe mund te shkaktoje nje sistem i tille radio.

Disa vende, per sistemet PMR caktojë pagesa , te cilat bazohen vetëm në numrin e stacioneve (stacioneve bazë dhe atyre portative, dore) dhe jo edhe ne zonen e mbulimit me sherbim. Nje rast i tille rezulton i padrejte.

Mund te ndodh, qe per nje sistem me zone sherbimi te madhe, deri dhe kombetar, por me numer te vogel stacioneve portative, pagesa mund te rezultoje me e vogel se per nje sistem PMR me nje numur te madh perdoruesish dhe me nje zone sherbimi shume te vogel deri 3 km. Sistemet Paging janë trajtuar si sisteme të ngjashme me sistemet PMR.

## 6.4 Licensat radio detare dhe avion

Përgjithësisht këto shërbime operojnë në breza te frekuencave që janë të rezervuara ndërkombëtarisht per keto shërbime. Rrjedhimisht, ka pak hapësirë për fleksibilitet në mënyrën se si është përdorur spektri.



Me e përshtatshme, gje qe aplikohet ne shumcen e vendeve, eshte pagese qe bazohen ne koston e perpumimit dhe administrimit..

Krahasimi i pageses aktuale per License Radio Anije dhe Avion, perkatsisht,15000 dhe 10.000 leke/ ne vit, me ate vendeve te BE (zakonisht në nivelin € 15 - € 77 për vit), mendojme se eshte pak me i larte per sherbimin detar.

## **PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJE PËR KONSULTIM**

## **Përdorimit optimal i spektrit Radio**

*Pyetja 1. A ka faktorë të tjerë, të pa përmendur më sipër, që AKEP duhet të marrë në konsideratë për përdorimin optimal të spektrit të radios dhe vendosjen e pagesave për përdorimin e spektrit të frekuencave?*

### **4.1 Sherbimi telefonik publik i levizshëm tokesor**

*Pyetja 2. Cilat janë pikëpamjet tuaja për pagesat vjetore që propozohen për brezat GSM900/1800 dhe UMTS?*

### **4.2 Sherbimi privat i levizshëm radio – PMR,**

### **4.3 Sherbimi i levizshëm TETRA**

### **4.4 Sherbimi kerkimit të personit ( Paging )**

*Pyetja 3. Cili është mendimi juaj për pajisjen me AI me afat vlefshmerie maksimale 3(tri) vjeçare dhe kryerjen e pagesave për përdorimin e frekuencave para marrjes së tij?*

*Pyetja 4. Cili është mendimi juaj për strukturën e propozuar të pagesave për sherbimet radio PMR, Tetra dhe Paging?*

*Pyetja 5. Cili është mendimi juaj për propozimet ndarjen në kategori të ulët, të mesëm dhe të lartë të sistemeve PMR?*

*Pyetja 6. Cili është mendimi juaj lidhur me periudhën e zbatimit të kësaj strukture pagese?*

### **4.5 Lidhjet fikse radio**

*Pyetja 7. Cilat janë pikëpamjet tuaja për objektivat e deklaruar të AKEP lidhur me spektrin, për të lehtësuar hyrjen në treg dhe për të përdorur alternativa të tjera të infrastruktures; për të inkurajuar përdorimin e fibrave nga operatorët ekzistues, kërkesat e të cileve për kapacitete transmetimi janë rritur në atë masë, duke bërë që fibra optike të jetë një alternativë e mundshme, dhe për të inkurajuar përdorimin e pajisjeve me efikasitet të përdorimit të spektrit?*

*Pyetja 8. Cilat janë pikëpamjet tuaja mbi pagesat e përdorimit të spektrit për të arritur këto objektiva?*

*Pyetja 9. A ka objektiva të tjera apo konsiderata që ju mendojnë se AKEP duhet të marrë parasysh kur të përcaktoje pagesat për lidhjet fikse radio?*

*Pyetja 10. Cilat janë pikëpamjet tuaja mbi procesin e pajisjes me AI për përdorimin e frekuencave për lidhjet fikse dhe për pagesat e propozuara?*

*Pyetja 11. Cfare mendimi keni për propozim, për të aplikuar një tarifë të vetme ku të dyja polarizimet H dhe V janë vendosur në të njëjtën lidhje radio dhe të njëjtën frekuencë?*

*Pyetja 12. A pajtoheni me propozimin për të aplikuar një pagese per lidhjen PMP, 4 here me te madhe se pagesa e lidhjes P-P? Nëse nuk pajtoheni, cila eshte alternativa qe ju propozoni?*

*Pyetja 13. A pajtoheni me propozimin për të aplikuar një pagese per lidhjen fikse radio nje drejtimshë 2 here me te vogel se pagesa e lidhjes fikse perkatese dydrejtimshë? Nëse nuk pajtoheni, cila eshte alternative qe ju propozoni?*

*Pyetja 14. A keni ndonje mendim tjetër që duhet te merret ne konsiderate nga AKEP?*

#### **4.6 Sherbimi radio FWA/BWA**

*Pyetja 15 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per ndarjen ne zonat lokal/rajonal?*

*Pyetja 16 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per pagesat per perdorimin e frekuencave per autorizimet perkatese?*

#### **4.7 Sherbimet Satelitore**

*Pyetja 17 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per dhenien e Autorizimeve individual per lidhjet satelitore?*

*Pyetja 18 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per pagesat per lidhjet satelitore?*

#### **4.8 Licensat radio te anijeve**

*Pyetja 19. Cilat janë pikëpamjet tuaja në skemën e licencimit të propozuar për licencat radio anije dhe pagesat lidhur me to ?*

*Pyetja 20. Cilat janë pikëpamjet tuaja mbi propozimin për të lejuar transferimin e licencave radio te anijeve midis pronarëve ?*

*Pyetja 21. A ka ndonjë qasje tjetër që ju mendoni se duhet të merren parasysh?*

#### **4.9 Licensat radio te avionave**

*Pyetja 22. Cilat janë pikëpamjet tuaja në skemën e propozuar për licensen radio te avionit dhe pagesat që lidhen me te?*

*Pyetja 23. A ka ndonjë qasje tjetër që ju mendoni se duhet të merret parasysh?*

#### **4.10 Autorizimet individuale per qellime kerkimi, matjeje dhe prove.**

*Pyetja 24. Cilit eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme, lidhur me afatin e vlefshmerise se Autorizmit Individual dhe pagesen per perdorimin e frekuencave per kete sherbim radio.*

#### **4.11 Autorizime individual per ngjarje te vecanta.**

*Pyetja 25 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per sherbimin radio per ngjarje te vecanta.*

#### **4.12 Shërbimi RadioAmatori**

*Pyetja 26 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per sherbimin radioamator*

#### **4.13 Pagesa te tjera**

*Pyetja 27 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per nivelin e pagesave?*

#### **5. Pagesat per Caktimin dhe Perdorimin e numrave dhe serive numerike.**

*Pyetje28: Cili eshte mendimi juaj per nivelin e pagesave per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike te dhena ne tabelen e mesiperme.*